



Gjendja e të burgosurve me dënim të përjetshëm

*Pjesë nga raporti i 25-të i Përgjithshëm,
publikuar në vitin 2016*

Vërejtje paraprake

67. Në Raportin e 11-të Përgjithshëm mbi aktivitetet në vitin 2000, KPT-ja adresoi shkurtimisht çështjen e të burgosurve me dënim të përjetshëm dhe të tjerëve me dënime afatgjata. Në veçanti, shprehu shqetësimin se këtyre të burgosurve shpesh nuk u ofroheshin kushtet e përshtatshme materiale, aktivitetet dhe kontaktet njerëzore, dhe se shpesh u nënshtroheshin kufizimeve speciale që mund t'i përkeqësonin efektet e dëmshme të burgimit të tyre afatgjatë. Komisioni konsideron se ka ardhur koha për të shqyrtuar gjendjen e të burgosurve me dënim të përjetshëm në Evropë bazuar mbi përvojën që ka mbledhur nga vizitat në 15 vitet e fundit dhe duke marrë parasysh edhe zhvillimet në nivelet evropiane dhe universale, veçanërisht Rekomandimin Rec (2003) 23 të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi menaxhimin nga administrata e burgjeve të të burgosurve të përjetshëm dhe të tjerëve me dënime afatgjata.¹

Dënimi i përjetshëm

68. Për KPT-në, dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirim nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë. Periudha minimale e nevojshme për të shërbyer para se një i burgosur të përfitojë së pari nga lirimi me kusht ndryshon nga vendi në vend; më e ulëta është 12 vjet (p.sh. Danimarka dhe Finlanda) dhe 15 vjet (p.sh. Austria, Belgjika, Gjermania, Zvicra) dhe më e larta 40 vjet (p.sh. Turqia, në rastin e disa krimeve të shumëfishta).

Shumica e vendeve që zbatojnë dënime të përjetshme kanë një periudhë minimale prej 20 deri në 30 vjet. Në juridiksionin e Mbretërisë së Bashkuar, periudha minimale për të vuajtur në burg përcaktohet në kohën e dënimit nga ana e trupit gjykues; ligji nuk parashikon një periudhë absolute minimale në këtë drejtim. Disa vende të tjera (p.sh. Bullgaria, Lituania, Malta, Holanda dhe, për krime të caktuara, Hungaria, Republika Sllovaqe dhe Turqia) nuk kanë një sistem të lirimimit me kusht për të burgosurit e dënuar përjetësisht, prandaj dënimi me jetë mund të nënkuptojë fjalë për fjalë jetën (shih edhe paragrafin 73). Në anën tjetër, vlen të përmendet se një numër i shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nuk kanë burgim të përjetshëm në librin e statutit.² Në vend të kësaj, për krimet më të rënda kanë dënime të gjata të caktuara zakonisht duke filluar nga 20 në 40 vjet.

¹ Shih edhe Rregullat Evropiane të Burgjeve (2006) dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve, të rishikuara së fundmi (*Nelson Mandela Rules* - 2015).

² Për shembull, Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Portugalia, San Marino, Serbia, Sllovenia dhe Spanja. Më tej, në praktikë, dënimet me jetë nuk janë zbatuar kurrë në Islandë a Lihtenshtajn.

Historia e konceptit të dënimit të përjetshëm

69. Gjatë gjithë historisë, burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur pandashëm me dënimin me vdekje dhe progresivisht është bërë dënim alternativ për krimet më të rënda. Megjithatë, qëllimi fillestar i këtij zëvendësimi nuk ishte që të zbutej gjendja e personit të dënuar. Përkundrazi, pikëpamja mesjetare, e cila vazhdoi për shumë shekuj, ishte se burgimi me jetë në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin me vetmi do të shihej nga shkelësit si një alternativë më e keqe se vdekja. Në të njëjtën mënyrë, njëri nga argumentet për mbajtjen e dënimit me vdekje ishte pikërisht se burgimi i përjetshëm me punë të rëndë ishte aq i vështirë se do të shkaktonte më shumë vuajtje për individin në fjalë dhe të ishte më mizor sesa dënimi kapital. Nga perspektiva e sotme, pikëpamja që personat që e vuajnë dënimin e përjetshëm (ose madje çdo dënim tjetër) duhet të marrin dënim shtesë nga ashpërsia e kushteve në burg është haptazi e papranueshme. Megjithatë, një këndvështrim i tillë ende është i ngulitur thellë në opinionin publik në shumë vende evropiane.

Koncepti i burgimit të përjetshëm u prezantua në vitet 1990 në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, pas ratifikimit të Protokollit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që hiqte dënimin me vdekje. Ekzekutimi i fundit në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës u zhvillua më 1997 dhe, që nga viti 2013, Evropa ka qenë zonë e lirë prej dënimit me vdekje në ligj (me përjashtim të Bjellorusisë).³ Megjithatë, në shumë vende është konsideruar se publiku do të përkrahte heqjen e dënimit me vdekje vetëm nëse zëvendësimi i tij konsiderohej mjaftueshëm ndëshkues. Rrjedhimisht, personave të dënuar me vdekje iu ndryshuan dënimet në burgime të përjetshme, por duket se ka pasur pak planifikime të detajuara në lidhje me zbatimin e burgimeve të përjetshme. Njëkohësisht, gjatë 25 vjetëve të ekzistencës së KPT-së, ka pasur një rritje të shënuar në numrin e dënimeve me jetë të shqiptuara. Kjo mbase kryesisht është rezultat i dy faktorëve, heqjes ose pezullimit të dënimit me vdekje në të gjithë Evropën dhe të politikave të dënimit në të gjitha shtetet anëtare lidhur me krimet e rënda. Statistikat e fundit⁴ tregojnë se ka pasur gjithsej rreth 27.000 të burgosur me jetë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në vitin 2014. Në bazë të një mostre prej 22 vendeve për të cilat janë në dispozicion të dhëna relevante për një periudhë më të gjatë, numri i të burgosurve me jetë është rritur për 66% nga viti 2004 deri më 2014. Më tej, më 2014, në shtetet e ndryshme anëtare të Këshillit të Evropës (veçmas në Mbretërinë e Bashkuar (Angli dhe Uells), Gjermani, Itali dhe Zvicër) ka pasur rreth 7500 të burgosur që mbaheshin në paraburgim të pacaktuar për arsye të sigurisë ose mbrojtjes publike.

70. Në vitet 1990, ish-vendet komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore specifikuan një periudhë burgimi prej 20 deri në 35 vjet si ombrellë minimum për të gjitha dënimet e zbutura dhe dënimet e reja të përjetshme, pa u marrë parasysh ndonjë faktor individual derisa të ketë kaluar kjo periudhë. Po ashtu, shumë shtete nuk ia dolën të zhvillonin regjime për të burgosurit me jetë që t'u përshtateshin situatave të tyre individuale. Përkundrazi, të gjithë të burgosurit e tillë të dënuar janë konsideruar “të rrezikshëm” dhe në nevojë për kontroll të vazhdueshëm e të rreptë. Tani, 20 deri në 25 vjet më vonë, pasi disa të burgosur fillojnë t'i afrohen momentit kur mund të aplikojnë për lirim me kusht, ka një mirëkuptim se është bërë pak për t'u dhënë të burgosurve të tillë ndonjë shpresë reale të kthimit të sërishëm në komunitet. Vërtet, periudhat e gjata të trajtimit negativ nëpër burgje, që kufizojnë rëndë të drejtën për të mbajtur marrëdhënie me familjen dhe miqtë jashtë, dhe mungesa totale e përgatitjes për lirim ose planifikimit për riintegrim kanë gjasa që seriozisht ta pengojë aftësinë e të burgosurve për të funksionuar në komunitet e jashtme.

Disa nga vendet e lartpërmendura kanë arritur të kuptojnë nevojën për t'i përgatitur të burgosurit me jetë për lirim. Këto vende, si dhe ato që hoqën dënimin me vdekje shumë më herët, kanë vendosur masa gjyqësore, kuazi-gjyqësore, administrative ose ekzekutive për shqyrtimin e

³ Është prezantuar një moratorium në Federatën Ruse.

⁴ Statistikat Penale Vjetore të Këshillit të Evropës (SPACE) 2004.8 dhe 2014.7.

lirimit të të burgosurve me jetë në baza individuale. Janë zhvilluar regjime për ta adresuar sjelljen individuale të të burgosurve, duke u ofruar arsimim dhe punë. Më tej, janë nxitur kur është e mundshme kontaktet me botën e jashtme, veçmas me familjet, si dhe agjencitë publike dhe bamirëse të jashtme janë të angazhuara për ta siguruar përparimin e tyre përgjatë dënimit. E gjithë kjo shërben për t'ua ruajtur "njerëzimin" atyre gjatë dënimit dhe për t'i përgatitur për lirim. Menaxhimi i të burgosurve me jetë paraqet sfida për administratën e burgjeve që të mbajë atmosferë pozitive, veçanërisht në dekadën e parë të një burgimi të përjetshëm, por po ashtu ndërsa disa prej këtyre të burgosurve lëvizin drejt moshës së vjetër. Përvoja e këtyre shteteve ofron një burim të mirë njohurish në propozimin e teknikave për ta ruajtur respektin për të drejtat e të burgosurve me që përballen me dënime të papërcaktuara, edhe pse papërcaktueshmëria në vetvete, sado që mund të zgjasë, krijon presione të veçanta psikologjike për të burgosurit.

Gjetjet e KPT-së gjatë vizitave

71. KPT-ja ka vizituar një numër të madh të burgjeve në gjithë Evropën, në të cilat mbahen të burgosur të dënuar me jetë. Kushtet në të cilat të burgosurit e tillë mbahen ndryshonin dukshëm nga njëri objekt burgu në tjetrin. Në shumë vende, të dënuarit me jetë mbahen zakonisht bashkë me të burgosurit e tjerë dhe përfitojnë nga të njëjtat të drejta në kuptimin e regjimit (punë, arsim dhe aktivitete rekreative) dhe të kontaktit me botën e jashtme, sikurse të dënuarit e tjerë.

Megjithatë, në një varg vendesh - duke përfshirë Armeninë, Azerbajxhanin, Bullgarinë, Gjeorgjinë, Letoninë, Moldavinë, Rumaninë, Federatën Ruse, Turqinë (vetëm të burgosurit e dënuar me burgim të rëndë të përjetshëm) dhe Ukrainën⁵ - të dënuarit me jetë si rregull ishin të ndarë nga të burgosurit e tjerë. Në disa vende, KPT-ja ka vërejtur se të dënuarit me jetë i nënshtroheshin edhe një regjimi shumë të varfëruar dhe masave drastike të sigurisë. Sa për ilustrim, të burgosurit e dënuar me jetë mbylleshin në qelitë e tyre (vetëm ose në çifte) për 23 orë në ditë, nuk u lejoheshin të shoqëroheshin me të dënuarit me jetë nga qelitë e tjera (duke përfshirë ushtrimet jashtë), nuk lejoheshin të punonin jashtë qelisë së tyre ose nuk u ofrohej asnjë aktivitet i qëllimshëm fare. Për më tej, në disa vende, të dënuarit me jetë prangoseheshin sistematikisht dhe/ose kontrolloheshin duke i zhveshur sa herë që dilnin nga qelitë. Në disa institucione burgu, të burgosurit në fjalë shoqëroheshin edhe nga dy oficerë dhe një qen roje gjatë çdo lëvizjeje jashtë qelisë së tyre.

Për më tej, në një numër të objekteve të vizituara, të burgosurit u nënshtroheshin rregullave anakronike, qëllimi i vetëm i të cilave ishte të ndëshkoheshin më tej dhe të poshtëroheshin të burgosurit në fjalë (p.sh. ndalimi për t'u shtrirë në shtrat gjatë ditës, detyrimi për të recituar nenin përkatës të kodit penal me të cilin ishin dënuar, sa herë që një polic hapte derën e qelisë, detyrimi për të veshur një uniformë burgu me ngjyrë të caktuar, etj). Sipas mendimit të KPT-së, praktikat e tilla kanë qartazi efekt depersonalizues e poshtërues dhe janë të papranueshme.

Ia vlen të përmendet po ashtu se në disa vende, të drejtat e të dënuarve me jetë për kontakte me botën e jashtme (veçmas sa u përket vizitave) ishin tejet të kufizuara dhe dukshëm më të ulëta sesa ato të të burgosurve të tjerë.

72. Në disa nga vendet e lartpërmendura, janë ndërmarrë hapa në vitet e fundit nga autoritetet e burgut për t'i lehtësuar kushtet e paraburgimit të të burgosurve të dënuar me jetë, në veçanti, duke u ofruar të burgosurve punë dhe aktivitete të tjera të qëllimshme (duke përfshirë shoqërimin me të dënuarit e tjerë me jetë) dhe duke ndjekur një qasje më të individualizuar kur bëhet fjalë për zbatimin e masave të sigurisë. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për ta bërë situatën të kënaqshme. Për fat të keq, politikat mbi ekzekutimin e dënimeve ende shumë shpesh bazohen në

⁵ Në disa vende (p.sh. Çekia, Lituania dhe Republika Sllovake), të burgosurit e përjetshëm duhet të shërbejnë një periudhë të caktuar (mes 10 dhe 15 vjet) në një njësi e veçantë para se të mund të transferohen në një njësi të zakonshme të burgimit ku mund të shoqërohen me të burgosurit e tjerë.

supozimin se të burgosurit e përjetshëm janë nga përkufizimi veçmas të rrezikshëm dhe se regjimi i aplikuar për të burgosurit e tilla duhet në një mënyrë a tjetër të ketë karakter ndëshkues.

KPT dëshiron të ritheksojë se nuk mund të ketë justifikim për prangosjen sistematike ose kontrollin me zhveshje të të burgosurve, aq më shumë kur këto zbatohen në një mjedis tashmë të sigurt. Komiteti ka deklaruar vazhdimisht edhe se përdorimi i qenve brenda zonës së burgimit është i papranueshëm. Lidhur me këtë, Komiteti dëshiron të theksojë se përvoja në vende të ndryshme evropiane ka treguar që të burgosurit e përjetshëm nuk janë domosdo më të rrezikshme sesa të burgosurit e tjerë (shih edhe paragrafin 76). Për më tej, ç'është e vërteta, të burgosurit e përjetshëm - sikurse të gjithë të burgosurit – *dërgohen në burg si dënim dhe jo për të marrë dënimin.*

“Jetë domethënë jetë”

73. Siç u tha më lart, në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, një person mund të dënohet me burgim të përjetshëm pa mundësinë e liritimit me kusht. Kjo njihet si "dënim faktit ose për gjithë jetën". KPT-ja ka kritikuar vetë parimin e dënimeve të tilla në disa raporte vizitash, duke shprehur rezerva serioze për faktin se një i dënuar me burgim të përjetshëm konsiderohet një herë e mirë me qenë i rrezikshëm dhe privohet nga çdo shpresë për lirim me kusht (përveç me përjashtim të mëshirës ose të faljes). Komisioni është i mendimit se të burgoset një person me jetë pa ndonjë perspektivë të vërtetë të liritimit është çnjerëzore. Ia vlen po ashtu të përmendet se edhe personat që dënohen nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (ose gjykatat speciale ndërkombëtare) për krimet më të rënda si gjenocidi, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, mund të përfitojnë në parim në një fazë të caktuar nga lirim me kusht (i hershëm).

Vërtet, KPT-ja konsideron se një dënim me burg që nuk ofron mundësinë e liritimit përjashton nga arsyetimet thelbësore të vetë burgosjes, mundësisë për rehabilitim. Ndërsa dënim dhe mbrojtja publike janë elemente të rëndësishme të një dënimi me burg, duke përjashtuar që nga fillimi çdo shpresë për rehabilitimin dhe kthim në komunitet, e dehumanizon për rrjedhojë të burgosurin. Kjo nuk d.m.th. se të gjithë të burgosurit e përjetshëm duhet të lirohet herët a vonë; mbrojtja publike është çështje kyçe. Megjithatë, të gjitha dënimet e tilla duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi kuptimplotë dikur, bazuar në objektivat e individualizuar të planifikimit të dënimit të përcaktuara në fillim të dënimit dhe të rishikuara pastaj rregullisht. Kjo do të ofronte jo vetëm shpresë për të burgosurit, por edhe një objektiv për t'u synuar i cili do të duhej të motivonte sjellje pozitive. Kështu do t'i ndihmonte edhe administratat e burgjeve në trajtimin e individëve të cilët përndryshe nuk do të kishin shpresë as ndonjë gjë për të humbur.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut viteve të fundit ka shqyrtuar një numër rastesh kur gjykatat vendase kishin shqiptuar burgim të përjetshëm për të burgosurit pa mundësi për lirim të parakohshëm ose me kusht dhe kur, me përjashtim të rrethanave të mëshirës ose shumë të jashtëzakonshme, dënim me gjithë jetën nënkuptonte pikërisht këtë. Gjykimi më autoritativ i Gjykatës deri më sot, i kryer nga Dhoma e Madhe në *Vinter dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*,⁶ thekson se ishte në shpërputhje me dinjitetin njerëzor, dhe prandaj në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që shteti ta privonte personin nga liria e vet, pa u dhënë atyre të paktën një shans që një ditë ta rifitojnë lirinë.

Tri pasojat kryesore mund të dalin nga jurisprudenca ekzistuese e Gjykatës. *Legjislacioni* i shteteve anëtare duhet të ofrojë që tani e tutje për një kohë gjatë vuajtjes së dënimit, kur do të ketë mundësi për ta shqyrtuar atë dënim. Për më tej, shtetet anëtare duhet të krijojnë një *procedurë* me të cilën do të rishikohet dënim. Në fund, mbajtja në burg duhet të organizohet ashtu që t'u mundësojë të burgosurve me jetë që të përparojnë drejt rehabilitimit të tyre.

⁶ Shih *Vinter and Others v. the United Kingdom* [GC], nr. 66069/09, 130/10 dhe 3896/10, 9 korrik 2013.

Objektivat bazë dhe parimet për trajtimin e të dënuarve me jetë

74. Në pikëpamjen e KPT-së, objektivat dhe parimet për trajtimin e të burgosurve të dënuar me burgim të përjetshëm, të shpallur nga Këshilli i Ministrave në Rekomandimin Rec (2003) 23 mbi menaxhimin nga administratat e burgjeve të të burgosurve të përjetshëm dhe të tjerëve me dënim afatgjatë mbeten dokumenti referencial më i plotë për këtë grup të të burgosurve. Në përmbledhje, këto parime janë:

- *parimi i individualizimit*: çdo dënim me jetë duhet të bazohet në një plan individual të dënimit, i cili përshtatet për nevojat dhe rreziqet e të burgosurit;
- *parimi i normalizimit*: të burgosurit e përjetshëm duhet, si të gjithë të burgosurit, t'u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë të nevojshme për izolimin e tyre të sigurt dhe të rregullt;
- *parimi i përgjegjësisë*: të burgosurve të përjetshëm duhet t'u jepet mundësi për të ushtruar përgjegjësinë personale në jetën e përditshme në burg, duke përfshirë planifikimin e dënimit;
- *parimet e sigurisë dhe sigurimit*: duhet bërë një dallim i qartë mes çdo rreziku që vjen nga të burgosurit e përjetshëm për komunitetin e jashtëm dhe rreziqeve që u vijnë atyre nga të burgosurit dhe personat e tjerë që punojnë ose vizitojnë burgun;
- *parimi i mosndarjes*: të burgosurit e përjetshëm nuk duhet të ndahen mbi bazën e vetme të dënimit të tyre, por të lejohen të shoqërohen me të burgosurit e tjerë në bazë të vlerësimit të rrezikut që merr parasysh gjithë faktorët përkatës;
- *parimi i progresionit*: të burgosurit e përjetshëm duhet të inkurajohen dhe t'u mundësohet të lëvizin nëpër dënimin e tyre në kushte dhe regjime të përmirësuara në bazë të sjelljes së tyre individuale dhe bashkëpunimit me programet, stafin dhe të burgosurit e tjerë.

Vendosja e këtyre parimeve në praktikë

75. Burgjet duhet të jetë të sigurt, dhe të rregullta, për hir të të gjithë atyre që përfshihen në ta. Meqenëse me qenë i mbyllur, sidomos për një periudhë të panjohur, është vetvetiu e dëmshme për pothuajse të gjitha qeniet njerëzore, duhet të ndërmerren hapa për të minimizuar dëmin. Një metodë e rëndësishme për të arritur këtë për të burgosurit e përjetshëm është që tu jepet një datë e caktuar për shqyrtimin e parë për lirimin e mundshëm, dhe një program i përshtatur individual që ofron një varg real ndërhyrjesh për çdo të burgosur e që çon në drejtim të asaj date. Natyrisht, ky program do të kërkojë rishikim të rregullt, por objektivi duhet të jetë gjithmonë që të angazhohet i burgosuri në zhvillimin e tij dhe t'i ofrohen të burgosurit nivele dhe komente për performancën. Si rezultat, një program i tillë duhet të sigurojë që të gjithë të burgosurve të përjetshëm t'u jepet mundësia për t'i adresuar të gjitha aspektet e situatës së tyre përpara datës së shqyrtimit të parë. Kjo duhet të përfshijë kohën e kaluar në kushte më pak të sigurt, veçanërisht në pushim në komunitet drejt fundit të periudhës, për t'u siguruar që plani i menaxhimit të rrezikut dhe nevojave do të funksionojë jashtë një mjedisi të sigurt. Vazhdimësia e kujdesit në komunitet është jetike për riintegrimin e suksesshëm, dhe duhet të krijohet një plan për këtë mjaft kohë para datës së lirit.

Individualizimi

76. Përmbushja e këtyre parimeve të përgjithshme kërkon individualizimin e planifikimit të dënimit. KPT nisat nga njohuritë, bazuar në përvojën e vet, si dhe atë të shumë administratave të burgjeve, se të burgosurit e përjetshëm nuk janë detyrimisht më të rrezikshëm se të burgosurit e tjerë (shih edhe paragrafin 72); shumë prej tyre kanë interes afatgjatë për një mjedis të qëndrueshëm dhe pa konflikt. Po ashtu, ata që e nisin dënimin si të rrezikshëm mund të bëhen edhe dukshëm më pak të tillë, jo vetëm me kalimin e kohës gjatë dënimeve të gjata, por edhe me ndërhyrjet e shënjestruara dhe trajtimin njerëzor. Pas shqyrtimit të dënimit të përjetshëm, individualizimi duhet të vazhdojë me procesin e planifikimit të dënimit bazuar në vlerësimin e situatës individuale. Kjo kërkon një vlerësim të gjatë paraprak, të kryer mundësisht në një vend të dedikuar me stafin e duhur

në formën e oficerëve të burgjeve me përvojë dhe të trajnuar posaçërisht, psikologëve, edukatorëve dhe punonjësve socialë.

Edhe psikiatri duhet të jetë i përfshirë, kur ka indikacione të çështjeve të mundshme të shëndetit mendor. Detyra e këtij ekipi, në bashkëpunim me të burgosurit, është të zhvillojë të kuptuar sa më të plotë të situatës së të burgosurit, si brenda në mjedisin e mbikëqyrrur ashtu edhe në komunitet, si dhe të nevojave që ka i burgosuri për ndërhyrje të veçanta që qëndrimi në burg të bëhet sa më i dobishëm për përmbushjen e nevojave të identifikuara dhe përgatitjen për lirim. Duhet vënë në përdorim rreziku i akredituar si dhe instrumentet për vlerësimin e nevojave, të plotësuar me vlerësim profesional.⁷ Analiza rezultuese dhe plani, i cili duhet të ndahet sa më shumë me të burgosurin, bëhet një dokument burimor për të gjithë personat që punojnë me të burgosurin. Ai duhet të rishikohet rregullisht, me komentet që i jepen të burgosurit.

Zbatimi i planit të dënimit

77. *Parimet udhëzuese në zbatimin e planit të dënimit janë krejt të njëjta për të gjithë të burgosurit. Të burgosurit nuk duhet t'u nënshtrohen kufizimeve që nuk janë të nevojshme për ruajtjen e rendit të mirë, sigurisë dhe disiplinës brenda burgut. Në veçanti, niveli i sigurisë që vlen për çdo individ duhet të jetë në përpjesëtim me rrezikun e paraqitur nga personi. Natyra e shkeljes është vetëm njëri faktor për vlerësimin e kësaj. Si parim, vendosja e regjimit të burgimit të të burgosurve të përjetshëm duhet të mbetet tek autoritetet e burgut dhe gjithmonë të bazohet në një vlerësim individual të gjendjes së të burgosurve, e të mos jetë rezultat automatik i llojit të dënimit të shqiptuar (p.sh. gjyqtari dënues nuk duhet ta përcaktojë regjimin).*

78. *Njëllonj, përveç në fazën e vlerësimit, të burgosurit e përjetshëm nuk duhet të mbahen larg nga të burgosurit e tjerë të dënuar, edhe pse nuk do të ishte e paarsyeshme që të burgosurit afatgjatë të mbaheshin larg nga të burgosurit për afate shumë të shkurtra. Gjatësia e dënimit nuk mbart ndonjë lidhje me nivelin e rrezikut që mund të përfaqësojë i burgosuri i përjetshëm brenda një burgu, dhe parimi i normalizimit kërkon që të burgosurit e përjetshëm të mund të shoqërohen të paktën me të burgosurit e tjerë afatgjatë që kanë një datë të paracaktuar të lëshimit. Qarkullimi, edhe pse i kufizuar, që kjo mund ta krijojë, freskon përvojën e burgut për ata që do të mbetet të burgosur për një kohë shumë të gjatë.*

Përqendrimi i të burgosurve të përjetshëm në një burg të specializuar po ashtu rezulton me shumë të burgosur të tillë që mbahen larg familjeve dhe kontakteve të jashtme. Një dënim i përjetshëm në çdo rast do të vinte trysni mbi këto marrëdhënie; duke i shtuar kësaj se vendosja e të burgosurve në një distancë të konsiderueshme larg shtëpisë e zvogëlon mundësinë e ruajtjes së asaj që është element kyç për promovimin e risocializimit. Për më tej, nuk duhet të vendosen kufizime shtesë mbi të burgosurit e përjetshëm në krahasim me të burgosurit e tjerë të dënuar, kur është fjala për mundësitë që ata të mbajnë kontakte kuptimplota me familjet dhe personat e tjerë të afërt. Gjatë viteve të para të burgimit në veçanti, kufizimet në kontakte kanë gjasa të prishin ose edhe të shkatërrojnë marrëdhëniet e tilla. Është gjithashtu me rëndësi që të burgosurit e përjetshëm të kenë qasje të mirëfilltë në baza sa më të rregullta për vizita, telefonata, letra, gazeta, radio dhe televizion për të ruajtur ndjenjën e tyre të kontaktit me botën e jashtme.

79. *Të burgosurit e përjetshëm duhet të kenë qasje në një regjim sa më të plotë të aktiviteteve, dhe normalisht në shoqërim me të burgosurit e tjerë. Puna, arsimit, sportet, aktivitetet kulturore dhe hobit jo vetëm ndihmojnë për të kaluar kohë, por edhe kyçë për promovimin e shëndetit social dhe të mirëqenies mendore si dhe dhënies së aftësive të transferueshme të cilat do të jenë të dobishme*

⁷ Shih Rekomandimin CM/Rec (2014) 3 të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare lidhur me shkelësit e rrezikshëm.

gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit me burg. Përfshirja e të burgosurve në këto aktivitete, përveç pjesëmarrjes së tyre në ndërhyrjet e sjelljes ofenduese, përbën një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së çdo personi. Ato i mundësojnë stafit të të gjitha niveleve të kuptojë më mirë të burgosurit dhe të bëjë gjykime të informuara se kur do të ishte e përshtatshme për të burgosurit të përparojnë nëpër regjim dhe t'u besohet në kushte më të ulëta të sigurisë. Mundësia e progresionit të tillë është kyçe, për menaxhmentin e burgut dhe për të burgosurit. Ajo motivon dhe shpërblen të burgosurin, duke ofruar shkallëzime në botën e tyre përndryshe të pacaktuar, dhe siguron marrëdhënie më të thellë mes stafit vlerësues dhe të burgosurit, e cila kontribuon për *sigurinë dinamike*.

Vërtet, zbatimi efektiv i sigurisë dinamike duhet të japë kontribut të rëndësishëm në procesin e vlerësimit se kur është e sigurt t'i lejohet qasja të burgosurve në komunitet, fillimisht në formën e pushimit të shoqëruar të shkurtër, pastaj duke lëvizur drejt një qëndrimi të pashoqëruar gjatë natës dhe në fund lirit me kusht në komunitet. Stafi i mirë do të ketë zhvilluar një mirëkuptim të thellë rreth individit, që mund ta ndajë me organet vendimmarrëse dhe me ata që do të marrin përgjegjësinë për mbikëqyrjen dhe mbështetjen në komunitet. Shumë sisteme ekzistuese përdorimin stafin dobët, sidomos stafin e sigurisë me gradë të ulët që zakonisht shpenzojnë shumicën e kohës me të burgosurit. Ata shpesh dekurajohen – ose ndalohen - nga njohja me të burgosurit dhe kështu humbet një mundësi e madhe për zhvillimin e marrëdhënieve pozitive midis personelit dhe të dënuarve. Marrëdhëniet e tilla, brenda parametrave të duhur, jo vetëm rrisin sigurinë por edhe mund të ndihmojnë për t'i motivuar të burgosurit që të bashkëpunojnë me regjimet dhe t'i japin stafit një përvojë shumë më pozitive të punës në burg sesa është në dispozicion të punonjësve të burgut që veprojnë thjesht si një të hapës bravash. Natyrisht, kjo kërkon përzgjedhjen e duhur të stafit, trajnime, mbikëqyrje dhe përkrahje nga profesionistë të tjerë në sistem. Por përfitimet, siç janë provuar nga disa vende anëtare dhe vëzhguar nga KPT-ja, janë të dukshme.

80. Ka padyshim disa të burgosur të përjetshëm që janë shumë të rrezikshëm. Megjithatë, qasja duhet të jetë e njëjtë si për të burgosurit e tjerë të dënuar dhe përfshin: vlerësime të detajuara të gjendjes individuale të të burgosurit në fjalë; menaxhim të riskut me plane për t'i adresuar nevojat e individit dhe për ta reduktuar mundësinë e përsëritjes së veprës në afat më të gjatë, ndërsa ofrohet niveli i nevojshëm i mbrojtjes për të tjerët; rishikime të rregullta të masave të sigurisë. Objektivi, si me të gjithë të burgosurit e rrezikshëm, duhet të jetë që të reduktohet niveli i rrezikshmërisë nga ndërhyrjet e duhura dhe të kthehen të burgosurit në qarkullim normal sa më parë.

Përmbyllje

81. KPT u bën thirrje shteteve anëtare të rishikojnë trajtimin e të burgosurve të përjetshëm për t'u siguruar që ky është në përputhje me rrezikun individual që ata paraqesin, si në burg si për komunitetin e jashtëm, dhe jo thjesht si përgjigje ndaj dënimit të shqiptuar për ta. Në veçanti, duhet të merren hapa nga shtetet anëtare për të hequr detyrimin ligjor për t'i mbajtur të burgosurit e përjetshëm të ndarë nga të të burgosurit e tjerë (afatgjatë) dhe për t'i dhënë fund përdorimit sistematik të masave të sigurisë si prangat brenda burgut.

82. Më tej, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për t'u ofruar të burgosurve të përjetshëm një regjim të përshtatur për nevojat e tyre dhe për t'u ndihmuar që ta zvogëlojnë nivelin e rrezikut që paraqesin, për të minimizuar dëmin që dënimet e papërcaktuara detyrimisht shkaktojnë, për t'i mbajtur në kontakt me pjesën e jashtme të botës, për t'u ofruar mundësinë e lëshimit në komunitet nën licencë dhe për t'u siguruar se lirimi mund të ofrohet në mënyrë të sigurt, të paktën në shumicën dërrmuese të rasteve. Për këtë qëllim, duhet të vihet procedura që lejojnë rishikim të dënimit. Natyrisht, pasja e një mundësie thjesht formale për të aplikuar për lirim pas një kohe të caktuar nuk është e mjaftueshme; shtetet anëtare duhet të sigurohen, sidomos përmes mënyrës si i trajtojnë të burgosurit e përjetshëm, që kjo mundësi të jetë reale dhe efektive.